4. Certifikata mbahet në origjinal në bordin e mjetit gjatë gjithë kohës së udhëtimit dhe i paraqitet menjëherë organeve të autorizuara të kontrollit me kërkesën e tyre.

The Certificate in original must be kept on board of the vehicle throughout the journey and be produced whenever required by any authorized inspecting body.

5. Certifikata nuk mund të transferohet nga mbajtësi i saj te një tjetër.

(The certificate is not transferable from its holder to another).

6. Kjo certifikatë duhet t'i kthehet autoritetit kompetent që e ka lëshuar atë, pas mbarimit të afatit të vlefshmërisë, si dhe në rastet, kur mjeti ndryshon pronësinë, vendndodhjen, del nga përdorimi ose kur pëson ndryshime thelbësore të karakteristikave të tij.

This certificate must be returned to the issuing competent authority after the end of validity and in the cases when the vehicle is transferred to another owner, place, is out of use or there are changes in essential characteristics of the vehicle.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

Republic of Albania  
**MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE  
TELEKOMUNIKACIONIT**  
Ministry of Public Works, Transport and Telecommunication  
**DREJTORIA E LICENCIMIT**  
DIRECTORATE OF LICENCES

**AUTORIZIM**

*Authorization*

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_

No \_\_\_\_\_ date

**PËR SHËRBIMIN NË LINJË TË RREGULLT NË TRANSPORTIN  
NDËRKOMBËTAR TË UDHËTARËVE ME AUTOBUS**  
*(for regular line service in the international transport of passengers by bus)*

**I LËSHOHET:**

*Issued to:*

**Personit juridik:** \_\_\_\_\_

*Juridical person:*

**Administratori:** \_\_\_\_\_

*Administrator:*

**Me seli në:** \_\_\_\_\_

*Trade Address:*

**Sipas licencës:** nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_

*Based on the License: No \_\_\_\_\_, date \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_*

**Linja:** .....

*Journey*

**Itinerari me stacionet e nënvizuara:** .....

*Itinerary with the pick up and set down point underlined*

**Frekuenca:**.....

*Frequency*

**Autorizimi është i vlefshëm deri më datën** \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_.

*The Authorization is valid until*

\_\_\_\_\_

**Firma dhe vula**

*Signature and Stamp*

**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**  
**GENERAL PROVISIONS**

1. Shërbimet e rregullta janë shërbimet të cilat sigurojnë transportin e udhëtarëve në intervale të përcaktuara gjatë rrugëve të përcaktuara, udhëtarët merren dhe lihen në vendqëndrimet e përcaktuara më parë.

Regular services are services which provide for the carriage of passengers at specified intervals along specified routes, passengers being taken up and set down at predetermined stopping points.

2. Një kopje e autorizimit mbahet në bordin e mjetit gjatë gjithë kohës së udhëtimit dhe i paraqitet menjëherë organeve të autorizuar të kontrollit me kërkesën e tyre.

A copy of the Authorization must be kept on board of the vehicle throughout the journey and be produced whenever required by any authorized inspecting body.

3. Autorizimi nuk mund të transferohet nga mbajtësi i tij te një tjetër.

The authorization is not transferable from its holder to another.

4. Autorizimi nuk është me i vlefshëm kur:

The Authorization is no more longer valid, when:

a) i ka përfunduar afati i vlefshmërisë;

The term of validity is over;

b) në të mungojnë ose janë bërë të palexueshme:

In it are either missing or no more legible:

- emri i shoqërisë;

The name of company;

- nënshkrimi dhe vula e autoritetit kompetent;

The signature and stamp of the Competent Authority;

- data e fillimit dhe mbarimit të periudhës së vlefshmërisë.

The starting and the ending date of the validity time period.

5. Autoriteti kompetent që ka lëshuar autorizimin e heq atë, kur:

The Competent Authority who has issued the Authorization withdraws it, when:

- provohet se subjekti transportues ka paraqitur informacion jo të saktë dhe/ose të falsifikuar në lidhje me të dhënat e kërkuara për marrjen e autorizimit;

It is proved that the carrier has presented either incorrect or false information related to the data requested for issuing the authorization;

- janë kryer shkelje të rënda ose të përsëritura të rregullave në lidhje me sigurinë rrugore, gjendjen teknike të autobusit, orëve të punës dhe pushimit të drejtuesve të autobusit, si edhe të kushteve të tjera që janë përshkruar në autorizim për shërbimin në linjë të rregullt (Itinerari, frekuenca, vendqëndrimet etj).

Serious or repeated infringements of the regulations concerning road safety, technical condition of the bus, driving and rest time of the bus driver and to the other provisions described in the authorization for the regular line service (Itinerary, frequency, stations, etc), have been committed.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

Republic of Albania  
**MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE  
TELEKOMUNIKACIONIT**  
Ministry of Public Works, Transport and Telecommunication  
**DREJTORIA E LICENCIMIT**  
DIRECTORATE OF LICENCES

**AUTORIZIM**

*Authorization*

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_

No \_\_\_\_\_ date

**PËR**

**SHËRBBIMET E RREGULLTA TË SPECIALIZUARA NË TRANSPORTIN  
NDËRKOMBËTAR TË UDHËTARËVE ME AUTOBUS**

*(for special regular services in the international transport of passengers by bus)*

**I LËSHOHET:**

*Issued to:*

**Personit juridik:** \_\_\_\_\_

*Juridical person:*

**Administratori:** \_\_\_\_\_

*Administrator:*

**Me seli në:** \_\_\_\_\_

*Trade Address:*

**Sipas licencës:** nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_

*Based on the Licence:* no. \_\_\_\_\_, date \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_

**Linja:** .....

*Journey*

**Itinerari me stacionet e nënvizuara:**

.....

*Itinerary with the pick up and set down point underlined*

**Frekuenca:**.....

.....

*Frequency*

**Autorizimi** është i vlefshëm nga \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_\_ deri më \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_\_  
*The Authorization is valid from* \_\_\_\_\_ *until* \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_  
**Firma dhe vula**  
*Signature and Stamp*  
**e autoritetit kompetent**  
*of the Competent Authority*



DISPOZITA TË PËRGJITHSHME  
GENERAL PROVISIONS

1. Ky autorizim lejon vetëm shërbimet e rregullta të specializuara që përfshijnë transportet qytetëse kufitare, dhe kur lejohen sipas kushteve të vendosura në marrëveshjet bilaterale. (This authorization permits only special regular services that include urban carriage in frontier areas and pursuant to the conditions laid down on bilateral agreement).

2. Një kopje e autorizimit mbahet në bordin e mjetit gjatë gjithë kohës së udhëtimit dhe i paraqitet menjëherë organeve të autorizuar të kontrollit me kërkesën e tyre. (A copy of the Authorization must be kept on board of the vehicle throughout the journey and be produced whenever required by any authorised inspecting body).

3. Autorizimi nuk mund të transferohet nga mbajtësi i tij te një tjetër.

The authorization is not transferable from its holder to another.

4. Autorizimi nuk është më i vlefshëm, kur:

The Authorization is no more longer valid, when:

a) i ka përfunduar afati i vlefshmërisë;

The term of validity is over;

b) në të mungojnë ose janë bërë të palexueshme:

In it are either missing or no more legible:

- emri i shoqërisë; (the name of company);

- nënshkrimi dhe vula e autoritetit kompetent;

(The signature and stamp of the Competent Authority);

- data e fillimit dhe mbarimit të periudhës së vlefshmërisë.

(The starting and the ending date of the validity time period).

5. Autoriteti kompetent që ka lëshuar autorizimin e heq atë, kur:

The Competent Authority who has issued the Authorization withdraws it, when:

- provohet se subjekti transportues ka paraqitur informacion jo të saktë dhe/ose të falsifikuar, në lidhje me të dhënat e kërkuara, për marrjen e autorizimit;

It is proved that the carrier has presented either incorrect or false information related to the data requested for issuing the authorization;

- janë kryer shkelje të rënda ose të përsëritura të rregullave në lidhje me sigurinë rrugore, gjendjen teknike të autobusit, orëve të punës dhe pushimit të drejtuesve të autobusit, si edhe të kushteve të tjera që janë përshkruar në autorizim për shërbimin e rregullt të specializuar (Itinerari, frekuenca, vendqëndrimet etj.).

Serious or repeated infringements of the regulations concerning road safety, technical condition of the bus, driving and rest time of the bus driver and to the other provisions described in the authorization for the regular specialized line service (Itinerary, frequency, stations, etc), have been committed.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

Republic of Albania

**MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE  
TELEKOMUNIKACIONIT**

Ministry of Public Works, Transport and Telecommunication

**DREJTORIA E LICENCIMIT**

DIRECTORATE OF LICENCES

**AUTORIZIM**

*Authorization*

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_ / \_\_ / \_\_\_\_

*No date*

**PËR SHËRBIMIN VAJTJE-ARDHJE NË TRANSPORTIN  
NDËRKOMBËTAR TË UDHËTARËVE ME AUTOBUS**

*(for shuttle service in the international transport of passengers by bus)*

**I LËSHOHET:**

*Issued to:*

**Personit juridik:** \_\_\_\_\_

*Juridical person:*

**Administratori:** \_\_\_\_\_

*Administrator:*

**Me seli në:** \_\_\_\_\_

*Trade Address:*

**Sipas licencës:** nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_ / \_\_ / \_\_\_\_

*Based on the License: no date*

**Itinerari:** .....

*Itinerary*

**Frekuenca:** .....

..

*Frequency*

**Autorizimi është i vlefshëm nga** \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_ **deri më** \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_.

*The Authorization is valid from until*

**Firma dhe vula**  
*Signature and Stamp*  
**e autoritetit kompetent**  
*of the Competent Authority*

*Modeli 303*

**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**  
**GENERAL PROVISIONS**

1. Autorizimi lejon kryerjen e shërbimeve vajtje-ardhje në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve me autobus. (The authorization permits the shuttle services in international carriage of passengers by bus).

2. Shërbimet vajtje-ardhje janë shërbime që organizohen për të transportuar grupe udhëtarësh, të formuar më parë nga e njëjta zonë nisjeje dhe me të njëjtën zonë destinacioni me udhëtime të përsëritura vajtje dhe kthim. Të tilla grupe, të përbëra nga udhëtarë që kanë kryer udhëtimin e vajtjes, rikthehen në zonën e nisjes me anën e një udhëtimi pasues. Zonë nisjeje dhe destinacioni quhen vendet, së bashku me lokalitetet rrethuese, në të cilat respektivisht fillon dhe mbaron udhëtimi. (Shuttle services are services whereby, by means of repeated outward and return journeys, groups of passengers assembled in advance are carried from a single area of departure to a single area of destination. These groups, made up of passengers who have completed the outward journey, are carried back to the place of departure in the course of subsequent journey. "Area of departure" and "area of destination" mean respectively the place where the journey begins and the place where the journey ends, together with around localities).

3. Transportuesi është i detyruar të zbatojë dispozitat ligjore në fuqi në territorin e palës tjetër kontraktuese, në veçanti ato që lidhen me transportin dhe qarkullimin. (The carrier is obligated to apply of the law in force in the territory of the other contracting party, particularly with regard to transport and traffic).

4. Autorizimi nuk mund të transferohet nga mbajtësi i tij te një tjetër.  
(The authorization is not transferable from its holder to another).

5. Autorizimi është i pavlefshëm, kur: (The Authorization is no more longer valid, when):

a) i ka përfunduar afati i vlefshmërisë; (The term of validity is over);

b) në të mungojnë ose janë bërë të palexueshme:

(In it are either missing or no more legible the following specifications):

- emri i shoqërisë; (the name of company);

- nënshkrimi dhe vula e autoritetit kompetent;

(The signature and stamp of the Competent Authority);

- data e fillimit dhe mbarimit të periudhës së vlefshmërisë.

(The starting and the ending date of the validity time period);

6. Autorizimi hiqet nga autoriteti kompetent që e ka lëshuar atë, kur:

(The Competent Authority who has issued the Authorization withdraws it, when):

- nuk plotësohen më kushtet e vendosura në nenin 6 të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998; (No longer meets the conditions laid down in Article 6 of the Law no.8308, date 18.3.1998);

- provohet se subjekti transportues ka paraqitur informacion jo të saktë dhe/ose të falsifikuar, në lidhje me të dhënat e kërkuara, për marrjen e autorizimit. (It is proved that the carrier has presented either incorrect or false information related to the data requested for issuing the authorization).

7. Një kopje e autorizimit mbahet në bordin e mjetit gjatë gjithë kohës së udhëtimit dhe i paraqitet organeve të autorizuar të kontrollit me kërkesën e tyre. (A copy of the

Authorization must be kept on board of the vehicle throughout the journey and be produced whenever required by any authorized inspecting body).



# REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Republic of Albania

## MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT

Ministry of Public Works, Transport and Telecommunication

### DREJTORIA E LICENCIMIT

Directorate of Licences

## AUTORIZIM

*Authorization*

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_

*No date*

### PËR TRANSPORT NDËRKOMBËTAR TË UDHËTARËVE ME AUTOBUS

*(for the international carriage of passengers by bus)*

transport bilateral

transit

Mbajtësi i këtij autorizimi *(the holder of this authorization)*,

emri i shoqërisë së transportit: \_\_\_\_\_,

*full name or business name of the carrier*

me seli në: \_\_\_\_\_,

*trade address*

është i autorizuar të kryejë transport ndërkombëtar të udhëtarëve midis Shqipërisë dhe ..... (transit) në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas kushteve të vendosura në marrëveshjen bilaterale për transportin rrugor të udhëtarëve dhe sipas kushteve të vendosura në këtë autorizim.

*is authorized to carry out international carriage of passengers by road between Albania and ..... (transit) in territory of the Republic of Albania pursuant to the conditions laid down on bilateral agreement and in accordance with the general provisions of this authorization.*

Linja: .....

*Journey*

Pika e nisjes: .....

*Point of departure*

Pika e mbërritjes: .....

*Point of destination*

Itinerari me stacionet e nënvizuara: .....

*Itinerary with the pick up and set down point underlined*

Frekuenca, oraret, tarifat, harta: sipas anekseve bashkëlidhur

*Frequency, schedules*

*as in annexed table*

Autorizimi është i vlefshëm nga \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_ deri më \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_.

*The Authorization is valid from*

*until*

Firma dhe vula

*Signature and Stamp*

**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**  
**GENERAL PROVISIONS**

1. Ky autorizim është lëshuar në zbatim të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore” për operim në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve në territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe sipas kushteve të vendosura në marrëveshjen bilaterale për transportin rrugor.

(The authorization is issued pursuant to the law no.8308, dated 18.3.1998 “On Road Transport”, for operation in territory of the Republic of Albania and the conditions laid down on bilateral agreement for road transport).

2. Një kopje e autorizimit mbahet në bordin e mjetit gjatë gjithë kohës së udhëtimit dhe i paraqitet menjëherë organeve të autorizuar të kontrollit me kërkesën e tyre.



(A copy of the Authorization must be kept on board of the vehicle throughout the journey and be produced whenever required by any authorized inspecting body).

3. Autorizimi nuk mund të transferohet nga mbajtësi i tij te një tjetër.

(The authorization is not transferable from its holder to another).

**DOKUMENTI I KONTROLLIT PËR SHËRBIME TË RASTIT NË TRANSPORTIN  
NDËRKOMBËTAR TË UDHËTARËVE**

*(Control document for the occasional services in the international transport of passengers)*

<b>Targa e automjetit</b> (Number plate of vehicle)			<b>Numri i vendeve të udhëtarëve</b> (Number of passengers seats)		
					
<b>Data</b> <i>(date)</i>	<b>Nga</b> <i>( from )</i>	<b>Deri</b> <i>( to )</i>	<b>Distanca në km</b> <i>(distance in km)</i>	<b>Pika e kalimit kufirit</b> <i>( cross border point )</i>	
<b>Emri i operatorit të:</b> ..... transportit .....			<b>Emri i drejtuesve të mjetit:</b> 1. .... 2. ....		
<b>LISTA E UDHËTARËVE (PASSANGER WAYBILL)</b>					
<b>Nr.</b>	<b>EMËR MBIEMËR</b> <i>( Name and surname )</i>	<b>Nr.</b>	<b>EMËR MBIEMËR</b> <i>( Name and surname )</i>	<b>Nr.</b>	<b>EMËR, MBIEMËR</b> <i>( Name and surname )</i>
1		19		37	
2		20		38	
3		21		39	
4		22		40	
5		23		41	
6		24		42	
7		25		43	
8		26		44	
9		27		45	
10		28		46	
11		29		47	
12		30		48	
13		31		49	
14		32		50	
15		33		51	
16		34		52	
17		35		53	
18		36		54	
<b>VENDI DHE DATA E PLOTËSIMIT TË DOKUMENTIT TË KONTROLLIT</b> <i>(Place, date of the full fill of the control document)</i>			<b>FIRMA/ VULA E OPERATORIT TË TRANSPORTIT</b> <i>( Signature/ Stamp of transport operator )</i> _____		

<b>Autoriteti i kontrollit kufitar</b> (Cross border authority)				
--	--	--	--	--

*Modeli 305*

1. Ky dokument përdoret në shërbimet e rastit në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve sipas kushteve të vendosura në marrëveshjet bilaterale me shtete, të cilat nuk janë anëtare të Marrëveshjes INTERBUS.

This document is valid for occasional services in international passengers transport by the conditions laid down on bilateral agreement on the territory of states which are not a contracting party of Interbus Agreement.

2. Mbajtësi i këtij dokumenti është i detyruar të jetë i pajisur me licencë për transport ndërkombëtar të udhëtarëve me autobus.

The holder of this document is obliged to be equipped with the licence for the international transport of passengers by bus.

3. Operatori i transportit duhet të plotësojë dokumentin e kontrollit përpara fillimit të udhëtimit për çdo udhëtim të kryer në shërbimet e rastit.

The transport operator for each journey carried out as an occasional service must complete the control document, before the start of the journey.

---



**Modeli i librit të udhëtimit për shërbimet e rastit brenda vendit**

- Emri dhe simboli i qarkut .....
- Nr. i librit .....

**Shërbimet e rastit të udhëtarëve brenda vendit**

**LIBRI I UDHËTIMIT**

Për shërbimet e rastit në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit me autobus, në përputhje me:

kreun II.2 të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, nenin 23 të udhëzimit nr.15, datë 24.7.2007 ”Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”.

Emri i transportuesit:.....

Adresa:.....

.....

.....

.....

(Vendi i lëshimit të librit)

(Firma dhe vula e autoritetit që lëshon librin)

## SHËNIME

1. Libri i udhëtimit u lëshohet vetëm subjekteve të licencuara për transport udhëtarësh në linja të rregullta rrethqytetëse, ndërqytetëse ose turistike.

2. Libri i udhëtimit jep të drejtën e kryerjes së shërbimeve të rastit brenda vendit, që janë:

- udhëtimet me dyer të mbyllura, ku i njëjti autobus do të transportojë të njëjtin grup udhëtarësh përgjatë gjithë udhëtimit dhe do t'i sjellë përsëri në pikën nga ku u nisën;

- shërbime, që kryejnë udhëtimin në vajtje me ngarkesë dhe udhëtimin e kthimit pa ngarkesë. Pika e nisjes është në vendin ku është vendosur operatori i transportit;

- shërbimet gjatë të cilave udhëtimi në vajtje është kryer pa ngarkesë dhe gjithë udhëtarët të transportuar më parë nga i njëjti operator transporti kanë kryer udhëtimin e kthimit në pikën e nisjes.

3. Informacion rreth plotësimit të dokumentit të udhëtimit:

a) për çdo udhëtim të kryer si një shërbim të rastit, operatori i transportit duhet të plotësojë një dokument udhëtimi në dy kopje, para nisjes së udhëtimit;

Operatori i transportit mund të përdorë një listë udhëtarësh të plotësuar që më parë në një fletë të veçantë (listë vetjake), e cila do t'i bashkëngjitet dokumentit të udhëtimit. Vula ose kur është e nevojshme firma e transportuesit ose drejtuesit të automjetit duhet të vihen në dokumentin e udhëtimit dhe në listën vetjake.

b) fleta e parë e dokumentit të udhëtimit duhet të mbahet në autobus gjatë gjithë udhëtimit dhe të tregohet sa herë që kryhet kontroll nga organet e kontrollit;

c) gjatë shërbimeve të rastit, asnjë udhëtar nuk mund të hipë ose të zbresë gjatë udhëtimit;

d) transportuesi është i detyruar të sigurojë që dokumenti i udhëtimit është i plotësuar në mënyrën e duhur. Dokumenti i udhëtimit duhet të plotësohet me germa të mëdha shtypi dhe me bojë që nuk hiqet.



4. Libri i udhëtimit nuk mund t'i transferohet dikujt tjetër.

5. Libri i udhëtimit përdoret për 10 udhëtime të shërbimeve të rastit.

**DOKUMENTI I UDHËTIMIT PËR SHËRBIME TË RASTIT BRENDIA VENDIT**

Nr. i Librit:.....

Nr. i Listës së udhëtarëve. ....

 <p><b>Targa e automjetit</b></p>		 <p><b>Numri i vendeve të udhëtarëve</b></p>	
<p><b>Nga</b> (bashkia/ komuna)</p>	<p><b>Në</b> (bashkia/ komuna)</p>	<p><b>Km me ngarkesë</b></p>	<p><b>Km pa ngarkesë</b></p>
<p><b>Emri i operatorit të transportit</b></p> <p>.....</p>		<p><b>Emri i drejtuesve të mjetit: 1. ....</b></p> <p style="text-align: center;"><b>2.</b></p> <p>.....</p>	

**LISTA E UDHËTARËVE**

NR.	EMËR MBIEMËR	NR.	EMËR MBIEMËR	NR.	EMËR MBIEMËR
1		19		37	
2		20		38	
3		21		39	
4		22		40	
5		23		41	
6		24		42	
7		25		43	
8		26		44	
9		27		45	
10		28		46	
11		29		47	
12		30		48	
13		31		49	
14		32		50	
15		33		51	

16		34		52	
17		35		53	
18		36		54	
VENDI DHE DATA E PLOTËSIMIT TË DOKUMENTIT TË UDHËTIMIT			FIRMA/VULA E OPERATORIT TË TRANSPORTIT		
_____			_____		
AUTORITETI I KONTROLLIT					

**UDHËZIM**  
**Nr.39, datë 16.10.2007**

**PËR SHPËRNDARJEN E FORMULARËVE A2/1 NË DREJTORITË ARSIMORE  
RAJONALE DHE ZYRAT ARSIMORE**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, i ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.78, datë 8.2.2006 “Për krijimin e maturës shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta”, i ndryshuar,

**UDHËZOJ:**

1. Kuotat e mbetura të porealizuara si rezultat i regjistrimit paraprak dhe përfundimtar në universitetet publike do të plotësohen nga studentët kandidatë, të cilët:
  - a) nuk janë fitues në asnjë degë sipas formularit A2;
  - b) nuk janë regjistruar në asnjë fazë regjistrimi në universitetet publike;
  - c) kanë kryer regjistrimin paraprak, por jo atë përfundimtar.
2. Studentët kandidatë të tërheqin formularët A2/1 pranë DAR/ZA-ve përkatëse, duke filluar nga data 17 tetor 2007.
3. Udhëzimet për plotësimin e formularit A2/1 do të jepen, më datë 16 tetor 2007 nga Qendra e Përpunimit Informatik (QPI).
4. Formulari A2/1 të plotësohet nga studentët kandidatë nga data 17-21 tetor 2007 dhe të dorëzohet pranë DAR/ZA-ve deri më datë 22 tetor 2007.
5. Formularët A2/1 të plotësuar nga studentët kandidatë, si dhe formularët e paplotësuar dorëzohen në QPI, më datë 23 tetor 2007 nga DAR/ZA-të.
6. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Zëvendësministri i Arsimit dhe Shkencës, Drejtorja e Kurrikulës në MASH, Qendra e Përpunimit Informatik, drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore.

**MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS**  
**Genc Pollo**

**VENDIM**  
**Nr.57, datë 15.10.2007**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT NË  
VEPRIMTARINË E DEGËVE TË BANKAVE TË HUAJA”**

## KREU I TË PËRGJITHSHME

### Neni 1 Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është:

- a) përcaktimi i instrumenteve që sigurojnë ushtrimin në mënyrë të sigurt dhe të qëndrueshme të veprimtarisë së degës së bankës së huaj;
- b) vendosja e kufizimeve maksimale të ekspozimit ndaj disa prej rreziqeve në ushtrimin e veprimtarisë së degës së bankës së huaj;
- c) përcaktimi i kërkesave dhe i detyrimeve mbi raportimet dhe dokumentacionin verifikues për zbatimin e kësaj rregulloreje.

### Neni 2 Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë degët e bankave të huaja të licencuara nga Banka e Shqipërisë për të ushtruar veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë, që në vijim për thjeshtësi, në këtë rregullore, do të quhen “degë”.

### Neni 3 Baza ligjore

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar (më poshtë ligji “Për Bankën”) dhe të nenit 57, pika 2, nenit 58, pika 1, shkronjat “b” dhe “c”, nenit 59, pika 8 dhe nenit 108, pika 2 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” (më poshtë ligji “Për bankat”).

### Neni 4 Përkufizime

Për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e përdorur kanë të njëjtin kuptim si në nenin 4 të ligjit “Për bankat”, ndërsa termat e mëposhtëm do të kenë këto kuptime:

“Depozitë ekuivalente e kapitalit” (DEK-a) - është pjesa e kapitalit fillestar minimal të dhuruar dhe të paguar në para nga banka-mëmë, për ushtrimin e veprimtarisë nga dega e saj në Republikën e Shqipërisë, të cilën dega është e detyruar ta investojë në aktivet e përcaktuara në pikën 7 të nenit 59 të ligjit “Për bankat”, sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në këtë rregullore.

“Bankë-mëmë” - është banka e huaj, e licencuar për të ushtruar veprimtari bankare nga autoriteti përgjegjës i vendit të huaj, të cilës i është dhënë e drejta nga Banka e Shqipërisë për të hapur një degë të saj në Republikën e Shqipërisë.

## KREU II INSTRUMENTET E ADMINISTRIMIT TË RREZIKUT

### Neni 5 Llojet e instrumenteve

Sigurimi i ushtrimit të veprimtarisë bankare dhe/ose financiare të degës në mënyrë të sigurt dhe të qëndrueshme, si dhe përmbushja e detyrimeve të saj ndaj kreditorëve, bëhet nëpërmjet përdorimit të instrumenteve të mëposhtme:

- a) Garancive që ofron banka-mëmë për administrimin e rreziqeve të degës, sipas përcaktimeve të nenit 6 të kësaj rregulloreje.
- b) Investimit të DEK-ës, sipas përcaktimeve të pikës 7, neni 59 të ligjit “Për bankat” dhe të

dispozitive të kësaj rregulloreje.

#### Neni 6

### **Garancitë e bankës-mëmë**

Për administrimin e rreziqeve të degës, banka-mëmë mbështet veprimtarinë e degës nëpërmjet:

a) dhurimit të kapitalit fillestar, si edhe ruajtjes së niveleve të përshtatshme të DEK-ës, sipas kërkesave të kësaj rregulloreje;

b) angazhimit zyrtar (me shkrim) përpara Bankës së Shqipërisë se garanton me aktivet e saj të gjitha detyrimet që rrjedhin nga veprimtaritë e degës në Republikën e Shqipërisë;

c) mbulimit të humbjeve financiare të degës gjatë një viti financiar, brenda gjashtëmuajorit të parë të vitit pasardhës;

d) zbatimit të standardeve më të mira të përgjegjshmërisë në drejtim, nëpërmjet miratimit dhe zbatimit të procedurave të brendshme për ndarjen e qartë të përgjegjësisë, të përcaktimit të mënyrave të raportimit, të adoptimit të politikave të qarta kontabël, si dhe nëpërmjet miratimit dhe vënies në zbatim të sistemeve dhe programeve të përshtatshme të kontrollit të brendshëm të veprimtarisë së degës;

e) zbatimit të plotë të kuadrit rregullativ mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë;

f) dhënies së informacionit që i përket bankës-mëmë dhe që i nevojitet Bankës së Shqipërisë si autoritet mbikëqyrës i degës që vepron në Republikën e Shqipërisë.

#### Neni 7

### **Funksionet e investimit të DEK-ës**

Investimi i DEK-ës ka për qëllim të sigurojë:

a) qëndrueshmërinë e gjendjes financiare të degës si rrjedhim i investimit të saj në aktive me cilësi të lartë dhe me rrezik të ulët;

b) kthyeshmëri të shpejtë në cash ose në ekuivalentet e cash-it, duke ruajtur vlerën e saj në rast të kalimit të degës në procedurë likuidimi;

c) mbrojtjen e depozituesve të degës dhe përmbushjen e detyrimeve ndaj kreditorëve të tjerë, në rast se dega i nënshtrohet procedurave të likuidimit.

#### Neni 8

### **Madhësia e DEK-ës**

1. Madhësia minimale e DEK-ës (kundërvlehtë në lekë) duhet të jetë:

a) për dy vitet e para të veprimtarisë së degës, të paktën 50 për qind e kapitalit fillestar minimal të dhuruar dhe të paguar në para nga banka e huaj; dhe

b) në vazhdim, të paktën 90 për qind e kapitalit fillestar minimal të dhuruar dhe të paguar në para nga banka e huaj.

2. Në llogaritjen e madhësisë së DEK-ës nuk përfshihet shuma e rezervës së detyruar që dega mban pranë Bankës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 19 të ligjit “Për bankën”.

#### Neni 9

### **Investimi i DEK-ës**

1. Dega, pas marrjes së licencës, investon DEK-ën në të paktën një prej aktiveve të mëposhtme:

a) depozitë në Bankën e Shqipërisë me normë interesi të përcaktuar me marrëveshje midis tyre dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara në rregulloren për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të punës së Bankës së Shqipërisë;

b) bono thesari dhe obligacione të emetuara nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë;

c) letra me vlerë të emetuara nga Banka e Shqipërisë.

2. Dega nuk lejohet në asnjë rast të investojë DEK-ën pranë bankës mëmë.

3. Dega investon aktivet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, pranë Bankës së Shqipërisë, në rast se ajo i nënshtrohet procedurave të likuidimit.

### KREU III EKSPOZIMI NDAJ RREZIQEVE

#### Neni 10

##### **Kufijtë maksimalë të rrezikut**

1. Për rrezikun ndaj të cilit ekspozohet për veprimtari të veçanta apo për të gjithë veprimtarinë e saj, dega, zbaton kufizimet e mëposhtme:

a) teprica e kredisë nuk tejkalon 70 për qind të totalit të aktiveve të saj në fund të tremujorit paraardhës.

b) ekspozimi ndaj një personi dhe/ose personave të lidhur me të nuk tejkalon 5 për qind të totalit të aktiveve të saj në fund të tremujorit paraardhës.

2. Dega është e detyruar të monitorojë dhe të sigurohet për respektimin e kufizimeve të ekspozimit ndaj rrezikut, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, gjatë gjithë kohës së ushtrimit të veprimtarisë së saj.

3. Në rastet kur ekspozimet tejkalojnë kufizimet sipas pikës 1 të këtij neni, dega raporton menjëherë në Bankën e Shqipërisë. Njoftimi shoqërohet me propozimet për një plan masash dhe kohën e nevojshme për të rivendosur ekspozimet brenda kufizimeve të kësaj rregulloreje.

#### Neni 11

##### **Administrimi i rrezikut të sistemit**

1. Në funksion të parandalimit dhe administrimit të rrezikut të sistemit që buron nga veprimtaria e degës në territorin e Republikës së Shqipërisë, kjo e fundit duhet të zbatojë njëkohësisht kufizimet e mëposhtme:

a) vlera mesatare e aktiveve të saj, për 4 (katër) tremujorë radhazi, nuk duhet të tejkalojë 10 për qind të totalit të aktiveve të sistemit bankar;

b) vlera mesatare e depozitave të saj, për katër tremujorë radhazi nuk duhet të tejkalojë 10 për qind të depozitave të sistemit bankar.

2. Në rast se dega tejkalon kufizimet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, Banka e Shqipërisë njofton degën se në këtë rast ajo do t'i nënshtrohet kuadrit rregullator dhe mbikëqyrës të zbatueshëm për bankat.

### KREU IV MBIKËQYRJA DHE RAPORTIMI

#### Neni 12

##### **Masat mbikëqyrëse**

1. Për zbatimin e kërkesave dhe të detyrimeve të kësaj rregulloreje, Banka e Shqipërisë vlerëson në mënyrë të vazhdueshme:

a) madhësinë e DEK-ës sipas pikës 1 të nenit 8 të kësaj rregulloreje;

b) cilësinë e aktiveve në të cilën është investuar DEK-a, sipas pikës 1 të nenit 9 të kësaj rregulloreje.

2. Në rast mosplotësimi të detyrimeve të pikës 1 të këtij neni, Banka e Shqipërisë zbaton dispozitat e parashikuara në nenet 74 deri 91, të ligjit “Për bankat” dhe në aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij.

#### Neni 13

##### **Detyrimi për raportim**

1. Në zbatim të kërkesave dhe detyrimeve të kësaj rregulloreje, dega është e detyruar të raportojë çdo muaj në Bankën e Shqipërisë sipas formularëve nr.1 dhe nr.2, bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

2. Dega raporton në Bankën e Shqipërisë në përputhje me Sistemin Raportues të Unifikuar, të miratuar nga Banka e Shqipërisë për degën.

3. Dega paraqet në Bankën e Shqipërisë, brenda muajit pasardhës, raportet financiare tremujore të bankës-mëmë:

- a) raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit;
- b) kapitalin rregullator (fondet e veta);
- c) treguesin e kredisë me probleme ndaj totalit të kredisë;
- d) treguesin e kredisë me probleme neto ndaj kapitalit rregullator (fondet e veta);
- e) treguesin e shumës së fondeve rezervë për humbjet nga kreditë ndaj kredive me probleme;
- f) treguesin e aktiveve likuide ndaj totalit të aktiveve.

#### Neni 14

##### **Dokumentacioni i degës**

Për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, dega është e detyruar të mbajë në selinë e saj dhe të vërë në çdo kohë në dispozicion të Bankës së Shqipërisë, dokumentacionin e përcaktuar në pikën 2 të nenit 55 të ligjit “Për bankat”, si dhe:

- a) një kopje të marrëveshjes së bashkëpunimit të lidhur ndërmjet bankës-mëmë dhe Bankës së Shqipërisë;
- b) deklaratën e bankës-mëmë sipas pikës b të nenit 6 të kësaj rregulloreje;
- c) raportet financiare tremujore më të fundit të bankës-mëmë;
- d) raportin më të fundit të ekspertit kontabël të autorizuar për bankën-mëmë; dhe
- e) vlerësimin e performancës së bankës-mëmë nga agjencitë ndërkombëtare të vlerësimit (shoqëritë e rating-ut).

#### KREU V

##### **DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

#### Neni 15

Banka e Shqipërisë, në rast mosplotësimi të detyrimeve të kësaj rregullore, zbaton dispozitat e parashikuara në ligjin “Për bankat” dhe në aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij.

#### Neni 16

##### **Dispozitë transitore**

1. Të gjitha dispozitat e akteve nënligjore të tjera lidhur me mbikëqyrjen e degës, të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë përpara datës së hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, do të vazhdojnë të zbatohen pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje për aq sa ato nuk bien në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje.



2. Degët ekzistuese të bankave të huaja, të licencuara nga Banka e Shqipërisë përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregullore, janë të detyruara të plotësojnë të gjitha kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore, jo më vonë se 3 muaj pas hyrjes në fuqi të saj.

Neni 17  
**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Ardian Fullani**

Formulari nr.1

FORMULARI I DEPOZITËS EKUIVALENTE TË KAPITALIT		
Nr.	Depozita ekuivalente e kapitalit (DEK-a):	Shuma
1.	Depozitë në Bankën e Shqipërisë me normë interesi të përcaktuar me marrëveshje midis tyre.	
2.	Bono thesari dhe obligacione të emetuara nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë.	
3.	Letra me vlerë të emetuara nga Banka e Shqipërisë.	
	<b>SHUMA</b>	

Formulari nr.2

Kodi	MATJA DHE KONTROLLI I KUFIJVE TË RREZIKUT (në mijë lekë)	Shumat
1.	Totali i aktiveve në fund të tremujorit paraardhës	
2.	Teprica e kredisë e tremujorit raportues	
3.	Raporti tepricë kredie/totalit të aktiveve	
4.	Kufiri maksimal i rrezikut	70%
5.	5 % i totalit të aktiveve në fund të tremujorit paraardhës	
	Renditja e ekspozimeve	
	<b>Emri i përfituesit *</b>	<b>Shuma</b>
1.		
2.		
3.		
etj.		

\* raportohen personat dhe/ose personat e lidhur që tejkalojnë nivelit 5 %.

**KËRKESË**

Shtetësja Ilda Kamberi, e bija e Zaimit, e datëlindjes 1965, lindur në Skrapar dhe banuese në Tiranë, kërkon shpalljen të vdekur të shtetasit, Mehmet Qerim Kamberi.

**KËRKUESJA**  
**Ilda Kamberi**

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)  
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

## BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË
2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR
3. REGJISTRAT E NOTERISË
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHA TË NDRYSHME

## BOTIME TË REJA (Të përditësuara gusht 2007)

KODI PENAL

KODI I PROCEDURËS PENALE

KODI CIVIL

KODI I PROCEDURËS CIVILE

KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE

### *Së shpejti në treg:*

- Përmbledhëse e legjislacionit për taksa dhe tatime
- Përmbledhëse e legjislacionit për pronat
- Kodi i familjes (përfshirë legjislacioni për birësimet)

Hyri në shtyp më 22.10.2007  
Doli nga shtypi më 24.10.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Nënë Tereza”  
Tiranë, 2007

Çmimi 76 lekë